

UNDEF

The United Nations
Democracy Fund



FNUD

Fonds des Nations Unies
pour la démocratie



**Raport mbi realizimin e
premtimeve elektorale të
z. Erion Isai, Kryetari i
Bashkisë Kolonjë**

PROJEKTI

**“Ndjekja dhe verifikimi i
premtimeve të fushatës
zgjedhore në Shqipëri”**

Mbështetur nga:

**Fondi për Demokraci i Kombeve të
Bashkuara**

Për më tepër informacion vizitoni platformën online “Matësi Elektorale” (The Albanian Truth-o-Meter Platform):

www.matesielektor.al

Ju mirëpresim të kontribuoni me ide dhe sugjerime mbi shpenzimet/investimet buxhetore lokale apo të qeverisjes qendrore si dhe mbi premtimet elektorale të realizuara ose të parealizuara të të zgjedhurve lokalë dhe anëtarëve të qeverisë.

E-mail: rdakorca@gmail.com

Tel: + (355) 822 42626

Premtimet elektorale të z. Erion Isai, Kryetari i Bashkisë Kolonjë

1. Të gjithë qarkun ta zgjojmë dhe ta bëjmë Kolonjën të vizitueshme e të aksesueshme për turizmin dhe agroturizmin;
2. Kënd lojërash për fëmijët në Ersekë dhe Leskovik;
3. Strehë sociale për njerëzit e pamundur dhe vend ku të mblidhen të moshuarit për të biseduar dhe për të kaluar ditën;
4. Shkolla dinjitoze.

Burimi: <https://ata.gov.al/2019/06/15/isai-pas-30-qershorit-ndertimi-i-plote-aksit-te-dyte-te-rruges-korce-erseke/>

Për fshatin Rehovë:

1. Ujësjiellës i ri;
2. Restaurimi i 80 portave të fshatit;
3. Subvencionimi i ngritjes së bujtinave;
4. Rikualifikimi urban i qendrës së fshatit;
5. Kalldrëme të reja;
6. Rehabilitimi i rrugës që të çon për në Rehovë.

Për fshatin Borovë:

1. Ujësjiellës i ri;
2. Rehabilitimi i urës së Totës;
3. Kalldrëme të reja;
4. Rikualifikimi urban;
5. Vënia në funksion e Muzeut të Masakrës (Muzeu i Borovës).

Për fshatin Barmash:

1. Ndërtimi i rrjetit të brendshëm të ujësjiellësit;
2. Projekte të reja në shërbim të komunitetit të kësaj zone.

Për Leskovikun:

1. Ujësjiellës i ri;
2. Rehabilitimi i rrugës Ersekë-Leskovik;
3. Rehabilitimi i rrugës së llixhave të Sarandaporit;
4. Ta kthejmë Leskovikun në atraksionin turistik më të frekuentuar nga turistët vendas dhe të huaj.

Për fshatin Selenicë:

1. Ujësjiellës i ri;
2. Rehabilitimi i kanaleve vaditëse;
3. Subvencionet për fermerët;

4. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve.

Për Njësinë Administrative Mollas:

1. Ujësjetës i ri;
2. Rikualifikimi urban i qendrës Mollas.

Burimi: <https://www.facebook.com/Bashkia-Kolonj%C3%AB-270696680084258/>

Premtimet e arritura

1. Shtrimi me trotuare dhe vendosja e ndriçimit publik LED në rrugët “Gani Butka” dhe “Ropi e Stillo Gostivishti”.
2. Rikonstruksioni i aksit rrugor Korçë – Ersekë Loti 2, e cila do të shkurtojë ndjeshëm lidhjen e Kolonjës me Korçën
3. Rikonstruksioni i rrugës “Ahmet Bektashi” në qytetin e Ersekës. Ndërhyrja përfshiu: asfaltim, ndriçim rrugor LED, trotuaret si dhe gjelbërim.
4. Rikonstruksioni i rrugës turistike Rehovë - Shën Pjetër.
5. Qendër e re sociale “Motrat Qirjazi” në Kolonjë. Qendra do të shërbejë familjeve në nevojë, specifikave të veçanta për trajtim, si dhe emigrantëve vulnerabël.
6. Në Leskovik u shtruan 600 m kabëll i ri për ndriçim rrugor, në lagjen e “Kishës” dhe në rrugën e “Artizanatit” dhe “Bregut”.
7. Rikonstruksioni i plotë i Kopshtit nr. 1 në Kolonjë.
8. Rikonstruksioni i shtëpive të prekura nga tërmeti në fshatin Qafëzes, Nj. Adm. Mollas.
9. Zgjerim, çakullim dhe rehabilitim i kanaleve anësore në rrugën e fshatit Blush, Nj. Adm. Mollas.
10. Ndërimi dhe plotësimi i të gjitha llampave rrugore në Bashkinë Kolonjë, si dhe riparimi i linjave të ndriçimit rrugor nëpër fshatra.
11. Pastrimi total dhe sistemimi i rezervuarit të Kodrasit.
12. Sistem i ri ndriçimi në 3 rrugët e qytetit të Ersekës.
13. Sistemimi dhe shtimi i hapësirave të gjelbërta në qytetin e Ersekës.
14. Rikonstruksioni i shkollës “Jani Vreto” në Ersekë.
15. Linjë e re ujësjetësi në fshatin Qafëzes, Nj. Adm. Mollas.
16. Rivitalizimi i qendrës multifunktionale në Kolonjë.
17. Modernizimi dhe finalizimi i infrastrukturës së ujësjetësit në Ersekë, i cili do të sigurojë furnizim të pandërprerë për 1363 banorë të 14 fshatrave të Bashkisë Kolonjë, si dhe shtim të sasisë dhe presionit të ujit për 9000 banorë të Ersekës.

Premtime pjesërisht të arritura (në proces)

1. Ka nisur puna për rehabilitimin e rrugës Vishanj – Taç Poshtë. Punimet përfshijnë: zgjerim të rrugës, rulim, hapjen e kanaleve anësore dhe çakullim.
2. Vijon puna për rehabilitimin e rrugës së Dëshmorëve, e cila përfshin Asfaltim, trotuaret, ndriçim Led si dhe sistemim të lulishteve.

3. Kanë filluar punimet për ujësjellësin e ri të Mollasit, nga i cili do të përfitojnë 450 banorë.
4. Vazhdojnë ndërhyrjet në rrugët e fshatit Kodras – Dokollarë. Kjo ndërhyrje përfshin: hapje të kanaleve anësore, zgjerim të trasesë së rrugës, çakullim dhe rulim.
5. Vijon puna për riveshjen me asfalt të rrugës nacionale Ersekë – Mollas.
6. Në Leskovik vijojnë punimet tek ish – çerdhja e qytetit, e cila do të kthehet në apartament social për familjet e pastreha.

Burimi: <https://www.facebook.com/Bashkia-Kolonj%C3%AB-270696680084258>